



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.15, date 15/07/2024

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI
UJOR SIPËRFAQËSOR PËR UJITJE, DREJTORISË SË UJIT DHE
KULLIMIT LEZHË, ME VENDNDODHJE: LUMI MAT, NË
BASHKINË LEZHË, QARKU LEZHË.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për ujitje, të Drejtorisë së Ujit dhe Kullimit Lezhë, me vendndodhje: Lumi Mat në Bashkinë Lezhë, Qarku Lezhë.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i burimit ujor: Lumi Mat

Vendndodhja e burimit ujor (KRGJSH)

Pika e furnizimit me ujë i projektit të ujitjes Mat-Lezhë:

-X = 477030; Y = 4618304; Z = 14.4 m.m.n.d

Sipërfaqja e parcelës që do ujitet: S= 4500 ha

Prurja e ujit të kërkuar: Q = 5.5 m³/sek

Prurja mesatare vjetore: Q_{mes-vjet} = 103 m³/sek

Periudha e përdorimit të ujit: Qershor-Korrik-Gusht

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH):

-X = 465614.2; Y = 4619536.4; Z = 4.62 m.m.n.d

Prurja që shkarkohet: Q= 2.5 m³/sek

3. Gjatë ndërtimit dhe operimit të veprës së marrjes të koordinohet me projektin për mbrojtjen e kembës së Urës së Zogut.
4. Të monitorohet gjatë gjithë kohës dinamika e sedimenteve dhe bazamentit në Urën e Zogut dhe të merren masa mbrojtëse në rast gërryerjesh.
5. Në periudhën e plotave maksimale të mbahet në kontroll funksionimi kapërderdhësit në argjinaturën e kanalit të veprës së marrjes së ujit duke mos lejuar prishjen e kësaj strukture.
6. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI



The image shows a handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Gjergj Prendi'. The signature is written over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRISË' at the top, 'KËSHILLI I BASENIT UJOR' at the bottom, and 'MAT' in the center. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania, featuring a double-headed eagle.